



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1007/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri në çështjen përmbarimore të kreditorit KS “Siguria”, Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Qamil Hoxha”, nr.51, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat A.P. nga Prishtina, kundër debitorit N.P.N “Hidroterm” ShP.K., me nr. unik identifikues 810634867, me seli në Suharekë, rr. “Brigada 123”, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokate N.H. nga Suhareka, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 789/2023 të datës 06.06.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 20.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit N.P.N “Hidroterm” Sh.P.K., ndërsa Urdhri Përmbarimor P.nr. 789/23 i datës 06.06.2023 i lejuar nga Përmbarues Privat Isa Gacaferi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit KS “Siguria”, Sh.A, me datë 06.06.2023 ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr. 789/23, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit faturë me nr. 06437/10-2022 e datës 18.10.2022 e lëshuar në emër të policës së sigurimit me nr..... e datës 18.10.2022 , ashtu që është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 9,201.05 EUR (me shkronja: nëntë mijë e dyqind e një euro e zero pesë euro cent) si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar propozimin për përmbarim për shkak të cenimit qenësor të rregullave të procedurës përmbarimore nga neni 29 par 1.3 të LPP-së, dhe aplikimit të gabuar te LPP-së, duke shtuar se edhe titulli përmbarimor nuk është i përshtatshëm për përmbarim pasi që përpos tjerave, duhet të përmbajë vëllimin dhe

kohën e përmbushjes së detyrimit sipas faturës e në rastin konkret kemi të bëjmë me mos përputhje të faturës me barazim për obligimin e kryer. I ka propozuar gjykatës që propozimin për përmbarim të mos e pranoj si të bazuar dhe këtë çështje juridike ta kthen si të pa bazuar dhe pa argumentuar.

Kreditori në përgjigjen ndaj prapësimit, ka theksuar se debitori me rastin e ushtrimit të prapësimit ka për qëllim vetëm zvarritje të procedurës, sepse nuk ka paraqitur argumente të qarta se pse i njëjti e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, dhe të gjitha pretendimet e paraqitura janë të pa bazuara dhe nuk i plotësojnë asnjë nga shkaqet e parapara me dispozitat e nenit 71 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzojë të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, andaj u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm: faturën me nr. 06437/10-2022 të datës 18.10.2022 e cila i përmban të gjitha elementet e kërkuara sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje Gjykata konstatoi se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e vënë tek pranuesi i faturës dhe e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37

të LPP-së, andaj si e tillë është e përshtatshme për përmbarrim dhe paraqet bazë për lejimin e përmbarrimit.

Gjykata pati parasysh pretendimet e ngritura nga debitori në prapësim por gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e tilla, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarrimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1007/23 datë 20.12.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.